



Prishtinë, 24 mars 2010
Kodi i ZRrE-së: V_241_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

- Nenin 15/2 pika d) dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 2004/9, të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Nenin 4 dhe 12 të Rregullit për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Gjeneruese;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 100 MW, në lokacionin Shtime, të datës 22.09.2009, të ndërmarrjes “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW), sh.p.k, me adresë rruga “Tirana” nr. 2, Shtime, Republika e Kosovës;

Në mbledhjen e mbajtur me datë , 24 mars 2010, nxori këtë:

VENDIM

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) konstaton se ndërmarrja “**Kosova Ter. Windparkcompany**” (KTW), sh.p.k ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) nga era me kapacitet të instaluar prej 100 MW, në komunën e Shtimes.
- II. Aplikantit “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW), sh.p.k mund t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Neni 12 dhe 13 të Rregullit për Procedurën e Autorizimit dhe të kërkesave tjera të përfshira në Shtojcën I që i është bashkangjitur këtij Vendimi.
- III. Bazuar në Caqet Indikative të përcaktuara me UA nr. 06/2007, të datës 26.09.2007, të Ministrisë për Energji dhe Miniera (MEM), ZRRE ka të drejtën e përcaktimit të sasisë së energjisë elektrike nga ndërmarrja “**Kosova Ter. Windparkcompany**” (KTW), sh.p.k., e për të cilën do të aplikohet tarifa nxitëse (“feed-in”).
- IV. Ky Njoftim nuk nënkupton edhe lëshimin e Autorizimit përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën II të këtij Vendimi.

Arsyetim

- ZRrE me datë 22.09.2009 nga ndërmarrja “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW), sh.p.k, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 100 MW, në lokacionin e komunës së Shtimes.
- ZRrE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura me aplikacionit dhe pranimin të dëshmive plotësuese të kërkuara, dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve , do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRrE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura mund t'i drejtohen Gjykatës Kompetente, brenda 14 ditësh nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkangjitur këtij Vendimi është **Shtojca I** me **Listën e kërkesave** që duhet të përmbushen nga aplikuesi.

Bordi i ZRrE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

SHTOJCA I:

Përveç kërkesave të përcaktuara me nenin 12 dhe 13 të Rregullit për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gasit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte”, ndërmarrja “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW), sh.p.k, me adresë rruga “Tirana” nr. 2, Shtime, Republika e Kosovës, duhet ti përmbushë edhe kërkesat si në vijim:

1. **Kontratën/Marrëveshjen** detale në mes të KTW dhe SVEA lidhur me bashkë financim të projektit;
2. **Kontratën/Marrëveshjen** detale në mes të ORBIS dhe KTW (Kai Tonnie) lidhur me financimin e përbashkët të projektit;
3. **Kontratën/Marrëveshjen detale në mes të KTW-Germanishe Loyd (LD) lidhur me IPN (ekzekutimin e punëve Inxhinierike, Prokurimit dhe Ndërtimit);**
4. **Kontratën/Marrëveshjet** detale në mes KTW dhe Bankat si dhe të SVEA me Bankat lidhur me shumën, llojin e kredisë, afatet e kthimit të kredive etj. lidhur me financimin e projektit.
5. **Kontratën/Marrëveshjen** detale në mes KTW- VESTAS për furnizim me turbina- gjeneratorë ku do të precizohen ndër të tjera lloji, kapaciteti, afatet e dërgimi të gjeneratorëve etj.;
6. **Rikonfirmim të Ofertës për Kyçje të KOSTT.**

Të gjitha dëshmitë e cekura më lartë duhet të dorëzohen në një (1) origjinal dhe gjashtë (6) kopje të vërtetuara.

Në përputhje me Nenin 13.4 të Rregullit për Procedurën e Autorizimit, ZRrE-ja rezervon të drejtën që të kërkojë informata dhe të dhëna shtesë nga aplikanti në çfarëdo kohe gjatë procedurës së autorizimit.

Në emër të Bordit të ZRrE-së

Dr. Ali Hamiti
Kryesues i Bordit të ZRrE-së